



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:208283
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05440112

Ac.nr.8633/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.Z., nga fshati O....., Komuna e Podujevës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.S., avokat nga avokatura MBN në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.B., me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesave të autorizuara të palëve, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3038/2014 të datës 10.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen të pathemelta, ankesa e të autorizuarit të paditëses A.Z., nga fshati O....., Komuna e Podujevës, dhe ankesa e të autorizuarit të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3038/2014 i datës 10.02.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.3038/2014 të datës 10.02.2020, ka aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëse A.Z., nga fshati O....., Komuna e Podujevës. Në pikën një, ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të dëmit jomaterial dhe material për shkaktimin e aksidentit me datën 02.09.2014, t’ia paguaj shumat si vijon: a. dëmin jomaterial, në emër të dhimbjeve trupore-fizike shumë prej 1200 euro, në emër të përjetimit të frikës shumë prej 800 euro, b. dëmin material, në emër të ushqimit të përforcuar 100 euro, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj 100 euro dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit 4 euro. Në pikën dy, ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “Siguria” në Prishtinë, që paditëses si në pikën I të dispozitivit të këtij

aktgjykimi, t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit me datën 10.02.2020, e deri në pagesën definitive përpjesën e gjykuar të kompensimit si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 594 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditsh nga ditë e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor. Në pikën tre, ka refuzuar si të pabazuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit në emër të dëmit jo material mbi shumën e gjykuara dhe atë për: për dhimbje trupore-fizike shumë prej 2800 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 2200 euro, ndërsa në emër të kompensimit të dëmit material për ndihmë dhe kujdesin e huaj shumë prej 100 euro, ushqimit të përforcuar shumë prej 100 euro, dhe shpenzimeve të rehabilitimit fizioterapeutik shumë prej 300 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari paditëses, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale lidhur me lartësinë e kompensimit si dhe shpenzimeve të procedurës, me propozim për Gjykatën e Apelit, ankesën e paditëses ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj në kuptim të lartësisë së kompensimit dhe shpenzimeve të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, që ankesën ta aprovoj, aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesat janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, të precizuar me parashtrësën e datës 28.01.2020, ka kërkuar që të detyrohet e paditura për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, në shumë prej 7,704.00 euro.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: raporti policor nr.2014-AR-2021 datë 02.09.2014, ekspertiza mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë datë 04.12.2019, e punuar nga dr. S.D., - ortoped traumatolog dhe dr. Sh.H., - psikiatër dhe dëftesa nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës datë 02.09.2014. Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të ekzistimit të bazës së kërkesëpadisë ka vendosur lidhur me aprovimin e pjesëshëm të njëjtës duke u bazuar në dispozitat e nenit 136, 169, 179.1, 183.1, dhe 382.2 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditëses, i ka vërtetuar shumat e kompensimit të aprovuara në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, ndërsa ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e palës paditëse, sipas së cilës, shumat e kompensimit do të duhej të ishin me të larta, si dhe ankesën e palës së paditur sipas të cilës shumat e kompensimit do të duhet të ishin më të ulëta. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve (të lehta trupore), si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore, ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183 par.2 të LMD-së, (Ligji Nr. 04/L-077) i cili decidivisht thotë se: *‘Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror’*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Në mënyrë të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe mbi shumën në emër të dëmit material, për ushqim të përforcuar, ndihmë të personit të tretë dhe shpenzimeve të mjekimit meqë, siç theksohet edhe në ekspertizë mjekësore, paditësja ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, të pasur me vitamina, proteina dhe albumina dhe ndihmë të personit të tretë. Edhe pse një formë e tillë e dëmit është më e vështirë për t’u vërtetuar me prova konkrete, praktika e Gjykatave të Kosovës e njeh kompensimin e dëmit të tillë, e meqenëse është konstatuar nevoja për ushqim të përforcuar, atëherë rrjedhimisht e ligjërisht, paditëses i takon kompensimi për të. Gjykata ankimore ka vërtetuar kështu edhe pjesën refuzuese në emër të dëmit material për shpenzime të shërimit klimatik, pasi që referuar ekspertizës rezulton se për palën paditëse ka qenë i nevojshëm rehabilitimi fizioterapeutik në kohëzgjatje prej 10 ditësh, mirëpo për të njëjtën pala paditëse nuk ka bashkëngjitur prova materiale në bazë të cilëve do të mund të vërtetohej se paditësja ka qenë në terapi fizikale-rehabilitim.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kamatën e gjykuar, pasi që e njëjta është në përputhje me dispozitën e nenit 382 par.2

të LMD-së. Gjithashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, duke qenë se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 452 të LPK-së, ndërsa janë refuzuar si të pathemelta pretendimet e palës paditëse lidhur me shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8633/2021, me datë 05.03.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.